



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT**  
**TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT,**  
**SPORTIT DHE RINISË**

Nr. 843 prot.

Tiranë, më 30.04. 2020

Lënda: Kualifikimi i mësuesve për vitin shkollor 2019-2020

**DREJTORIVE RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**ZYRAVE VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Për djehni: **Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar**

**Qendrës së Shërbimeve Arsimore**

**Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar**

**Tiranë**

Në mbështetje të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 2, datë 12.02.2015, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve", i ndryshuar, ju bëjmë me dije se:

1. Provimi me shkrim për kategoritë e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2019-2020 do të zhvillohet më datën 04.04.2020, ora 10-12:30, në Tiranë, në mjedise të planifikuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP).
2. Programet e kualifikimit të vihen në shërbim të mësuesve kandidatë nga drejtoritë e përgjithshme të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), brenda datës 31 janar 2020. Programet mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të ASCAP.
3. Mësuesi kandidat për provimet e kualifikimit plotëson kërkesën për të marrë pjesë në procedurat e kualifikimit dhe e dorëzon atë në ZVAP së bashku me portofolin profesional sipas profilit përkatës, brenda datës 14 shkurt 2020.

4. Listat e kandidatëve për provimet e kualifikimit, së bashku me vlerësimet e portofolit, i harton ZVAP-ja përkatëse (sipas formatit të ASCAP), brenda datës 25 shkurt 2020.
5. Lista e kandidatëve për provimet e kualifikimit t'u bëhet e ditur mësuesve deri më 27 shkurt 2020, në mënyrë që secili mësues kandidat të kontrollojë të dhënat dhe vlerësimet e portofolit të tij.
6. DRAP-ja harton listat përfundimtare për të gjitha ZVAP-të në juridiksion të saj, sipas formatit të ASCAP-së për hedhjen e të dhënave dhe i dërgon në formë elektronike dhe zyrtare në ASCAP dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), brenda datës 5 mars 2020. Pas kësaj date nuk bëhen ndryshime në listën e mësuesve kandidatë.
7. DPAP-ja, në bashkëpunim me ASCAP-në, harton listën e përgjegjësve të administrimit, administratorëve dhe sekretuesve të provimit të kualifikimit sipas mjediseve dhe numrit të përcaktuar nga ASCAP-ja.
8. ASCAP-ja të organizojë seanca informuese me DPAP-në, DRAP-të dhe ZVAP-të për procedurat e organizimit të kualifikimit të mësuesve.

Duke ju falënderuar,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

